



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 47/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

## V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit AAB, Nr 3502/21H, datë 29.10.2021 për riakreditim të programeve të studimit, si më poshtë:

- Gjuhë Angleze, MA, 120 ECTS
- Administratë Publike dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS
- Teknik i Radiologjisë, BSc, 180 ECTS
- Dizajn Enterier, BA, 180 ECTS
- Marketing Digjital dhe Media Sociale, BA, 180 ECTS

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m i

Kolegji AAB ka parashtruar kërkesë (Nr 3502/21H, datë 29.10.2021), në Agjencinë e Kosovës për ri/akreditim për akreditim të programeve të studimit.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur më 21 dhjetor 2021 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit AAB. Në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, thuhet, “Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”.

Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 21 dhjetor 2021, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KShC mori vendim që të refuzoj pjesërisht aprovimin e aplikacionit të Kolegjit AAB. Bazuar në nenin e referuar më sipër KShC ka verifikuar te gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit.

- **Për programin e studimit: Gjuhë Angleze, MA, 120 ECTS**, janë vendosur si bartës të programit këta persona: Xhavit Rexhaj dhe Mirvan Xhemajli.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit, Kolegji AAB duhet të ketë të paktën dy staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, u konstatua që Xhavit Rexhaj ka gradë akademike PhD në fushën e pedagogjisë. Për më tepër, diploma e tij është lëshuar nga fakulteti i edukimit. Sa i përket bartësit të dytë Mirvan Xhemajli, grada e tij shkencore PhD është në fushën e filologjisë (mësimi i gjuhës shqipe).

- **Për programin e studimit: Administratë Publike dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS**, janë vendosur si bartës të programit këta persona: Besard Belegu dhe Matilda Pajo.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, u konstatua që asnjëri nga bartësit e programit nuk e mbulon fushën e diplomacisë, pasi as grada akademike dhe as publikimet e tyre nuk ndërlidhen me diplomacinë. Për më tepër, programi në vete ka përmbajtje mjaft të zgjeruar, dhe rezultatet e të nxëniet (learning outcomes) në mes të Administratës Publike dhe asaj të Diplomacisë janë shumë të ndryshme, dhe madje bien në kode të ndryshme brenda Erasmus Subject Area Code (ESAC).

- **Për programin e studimit: Teknik i Radiologjisë, BSc, 180 ECTS**, janë vendosur si bartës të programit këta persona: Gazmend Vokshi, Valon Xhelili, Medina Ceko, Bujar Selimi.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, u konstatua që asnjëri nga bartësit e programit nuk e mbulon fushën e Radiologjisë të përcaktuar me Erasmus Subject Area Code (ESAC). Bartësi i parë z. Izet Sadiku ka gradën PhD në Mjekësi, dhe i specializuar në infektologji, z. Sehad Kadriu ka PhD në fushën e Fizikës, Verpim Shehu ka PhD në fushën Mjekësisë, dhe i specializuar në sëmundjet e organeve respirale dhe tuberkulozit, Daut Gorani ka PhD në Mjekësi të Përgjithshme, Bujar Gjokolli ka vetëm gradë akademike PhD Cand., dhe Milaim Kosumi ka gradën akademike PhD në Mjekësi të Përgjithshme.



- **Për programin e studimit: Dizajn Enterier, BA, 180 ECTS**, janë vendosur si bartës të programit këta persona: Gazmend Vokshi, Valon Xhelili, Medina Ceko, Bujar Selimi.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, u konstatua që vetëm Bujar Selimi ka kualifikimin adekuat që të jetë bartës i këtij programi, ashtu siç është e përcaktuar me kriteret e UA 15/2018. Sipas dokumentacionit të dorëzuar, dhe verifikimit nga AKA, rezulton se Gazmend Vokshi ka gradën akademike MA në Arkitekturë, Valon Xhelili ka gradën akademike MA në Arkitekturë, dhe Medina Ceko ka gradën akademike MA në Arkitekturë, e që asnjëra nuk përkojnë me fushën e përcaktuar me kategorinë e Dizajnit Enterier të përcaktuar me Erasmus Subject Area Code (ESAC).

- **Për programin e studimit: Marketing Digjital dhe Media Sociale, BA, 180 ECTS**, janë vendosur si bartës të programit këta persona: Fidan Qerimi, Rrezarta Gashi, Besime Ziberi, Shaip Bytyci.

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, u konstatua që asnjëri nga bartësit e programit nuk e mbulon fushën e Marketingut Digjital dhe as atë të Mediave Sociale. Fidan Qerimi ka grade shkencore PhD në Ekonomi dhe Menaxhment, Rrezarta Gashi ka gradë shkencore në Ekonomi dhe Menaxhment, Besime Ziberi ka gradë shkencore në Ekonomi, dhe Shaip Bytyci ka gradë shkencore në Sigurime.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësive

